

Fleta e punës për nxënësit 5.4

Rregullat procedurale për konferencën - draft

Miratimi i rregullave procedurale

1. Komuniteti miraton një projekt rregullash procedurale nga një shumicë prej 50% ose më shumë të të gjitha votave të hedhura.
2. Në qoftë se nuk ka ndryshime të sugjeruara për këtë projekt, ai mund të miratohet nga një votë në bllok. Ndryshimet duhet të votohen veçmas.

Kryetari

3. Me shumicë votash, një anëtar i komunitetit emërohet si kryetar. Kryetari mund të marrë pjesë në votimit të projektligjeve të kornizës, por nuk mund të kryejnë rolin e zëdhënësit (rregulla nr. 5).

Deklarata përfundimtare e promovimit

4. Anëtarët e komunitetit tregojnë preferencën e tyre për një projekt model përmes votimit. Ata formojnë parti që mund të llojë për modelin e tyre.
5. Një zëdhënës bën një deklaratë promovuese për partinë e tij, që zgjat jo më shumë se dy minuta.
6. Gjatë procedurës së votimit nuk lejohet debat i mëtejshëm.

Procedura e votimit

7. Votimi: anëtarët e komunitetit të miratojnë një projekt me votë. Të gjitha votat numërohen në mënyrë të barabartë. Anëtarët votojnë me shfaqjen e duarve.
8. Vendim me dy-faza: votimi i drafteve zhvillohet në dy raunde.

8.1 Raundi i parë: anëtarët e komunitetit votojnë për një nga drafetet.

8.2 Raundi i dytë: të dy drafetet me sasinë më të lartë të votave votohen në një kohë të dytë. Komuniteti miraton draftin që merr numrin më të lartë të votave.

8.3 Nëse të dy drafetet marrin numër të barabartë votash, organizohet një diskutim para se të përsëritet votimi.

Dokumentimi dhe autorizimi

9. Shkruesi i draftit shkruan datën dhe vendin e konferencës në fund të dokumentit rregullator.
10. Të gjithë anëtarët e komunitetit nënshkruajnë dokumentin.